



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 006/24 Dt. 12.01.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data/Date:	12.01.2024
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit dhe hartimit të Projekt-Strategjinë komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17- Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me 22.11.2022, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për hartimin e Projekt- Strategjinë komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027, anëtarët e këtij grupi janë: Edmond Hoxha, kryesues; Egzona Hoxhaj, anëtare; Ymer Berisha, anëtarë; Reshit Kushaj, anëtarë; Vetan Xhemaj, anëtarë; Idaim Kryeziu, anëtarë; Bashkim Rakaj, anëtarë; Përparim Shala, anëtarë; Xhejlane Gjini, anëtare; Fatlum Berisha, anëtarë; Eroll Shabani OJQ-EcMaNdryshe, anëtarë; një përfaqësues të OJQ-ve që merren me persona me nevoja të veçanta; një përfaqësues nga OSBE-ja.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **11.12.2023** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2023/12/Njoftimi-Strategjia-komunale-dhe-plani-i-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në facebook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02iGibBgEMtt9Afs2k3A89MGWTHZywhiJ4qfs3RZKmkSbPxo2UKhcYKxEgxdM5j1Lol&id=100064489910139&mibextid=RtaFA8

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42215>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-strategjine-komunale-dhe-planit-te-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-2024-2027/>

Me 12.12.2023, njoftimi dhe strategjia përmes emailit u është dërguar: Qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata, drejtor të shkollave fillore dhe të mesme, bizneseve, organizatave studentore, ekspertëve të fushave të ndryshme, mediat lokale, shoqata të ndryshme, organizata rinore si dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal. **(Përmes emailave, njoftimi dhe strategjia u është dërguar 871 emaila)**

Me 20.12.2023, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-strategjine-komunale-dhe-planit-te-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-2024-2027/>

Në facebook:

Projekt-Strategjinë komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027 (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 26.12.2023, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2023/12/Procesverbali-nga-mbajtja-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Projekt-Strategjine-komunale-dhe-plani-i-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-2024-2027-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data 11.12.2023 deri me 11.12.2024, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë 11.01.2024.

Përmes formës elektronike janë pranuar 36 komente, nuk është pranuar asnjë koment në formë fizike kurse 10 komente janë pranuar gjatë mbajtjes së konsultimit.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Projekt-Strategjinë komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027	20.12.2023 Nga-10:15 Deri-12:00	F M T 10 6 16	8	46 11-Pjesërisht 5-Refuzohen 30-Pranuara

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1	1-Kërkoj qe personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje fizike në të gjitha institucionet ,qasje p.sh. në objektin e komunës kati i dytë qasja në të gjitha institucionet publike pasi ka mungesa të ashensorëve ,pjerrinave deri tek tualetet	Bashkim Gashi, qytetarë (komenti gjatë pranuar konsultimit)	Pjesërisht	Çdo objekt i ri ka qasje për persona me aftësi të kufizuara.
	2-Kërkon ndarjen e donacioneve për qasje neper shtëpitë e tyre. Përfshirja në arsim duhet të filloj nga mosha e hershme e fëmijëve .Sa i përket strategjisë ai kërkoj qe kjo strategji të përkrahët 50% të paktën nëse realizohet do të ishte sukses		Pranohet	Sipas akteve ligjore, këto çështje janë të rregulluara me ligj.

2	1-Dokumenti është shumë voluminoz e njëjta nuk shpreson se do te përmbushen këto pese objektiva strategjike	Resmije Rahmani (komenti pranuar gjatë konsultimit)	Refuzohet	Dokumenti është hartuar me ekspert të fushës.
	2-Rëndësi i ka kushtuar qasjes së personave në institucione dhe gjithëpërfshirës . Thekson se i kisha ndërruar renditjen e objektivave pasi e para nga objektivat sipas saj është qasja ne te gjitha institucionet .		Refuzohet	Dokumenti është hartuar me ekspert të fushës.
3	1-Vërejtja ime është qasja e personave me aftësi të kufizuar kërkon qe urgjente te mbahet një data baze për këtë kategori	Antigona Shestan (komenti pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Drejtoria përkatëse, ka data bazë për këto kategori.
	2-Kërkoj një buxhet te sigurt për përkrahjen e këtyre personave.		Pjesërisht	Shteti financon personat me aftësi të kufizuara, kurse drejtoria përkatëse shpall thirrje publike për përkrahjen e projekteve për persona me aftësi të kufizuara.
4	1-Kërkon te ketë foto dhe shkrimi te lexueshëm siç është alfabeti Braile (Braj).	Përparim Krasniqi (komenti pranuar gjatë konsultimit)	Pjesërisht	Komuna në koordinim me institucionet qendrore, do të realizon programe të kësaj natyre.
5	1-Ku jeni bazuar ne koston buxhetore duhet te hulumtoni dhe te bazoheni edhe ne komunat tjera duke marr shembull Prishtinën	Eroll Shabani EcMaNdryshe (komenti pranuar gjatë konsultimit)	Pranohet	Komuna merr për bazë praktikat e mira në institucionet tjera komunale.
	2-Gjithashtu si shqetësim kryesor për këta persona ka ngritur edhe Qasjen e këtyre personave si në: stacione te autobusëve , mandej çështjen e zgjidhjes se banimit për këta persona , ndërtimi i banesave per ketë kategori dhe bashkëpunimi si dhe gjithë përfshirjen ne te gjitha aktivitetet		Refuzohet	Kjo kërkesë i takon institucioneve qendrore.
6	1-Kërkoj qe personat e verbër te cilët janë neper shkolla te kenë asistencë mobile dhe pajisjet per personat e verbër ,makinat e shkrimit, syzat ,shkopinjte etj.	Yilka Berisha (komenti pranuar gjatë konsultimit)	Refuzohet	Është kompetencë e nivelit qendrorë.

7	1-Të redaktohet dhe lektorohet teksti i këtij dokumenti, pasi ka lëshime teknike.	OJQ-Demokraci Plus (D+) (komenti pranuar në formë elektronike)	Pranohet	Secili dokument komunal lekturohet nga lektorja.
	2-Në këtë rast, duhet përshtatur edhe infrastrukturën rrugore përfshirë këtu troturaret të cilat duhet të jenë të qasshme për persona me karrocë, personat e verbër etj.		Pranohet	Në kuadër të ridizajnit të infrastrukturës po intervenohet për të krijuar qasje për këtë kategori.
	3-Të shtohet këtu një aktivitet që do të mundësoj vendosjen e tabelave/postereve sa më të përshtatshëm informues për PAK brenda objekteve shëndetësore dhe sociale (në ato institucione të identifikuara të cilat nuk janë të pajisura).		Pjesërisht	Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve nëpër institucione vendosja po zëvendësohet me teknologji bash kohore.
	4-Të specifikohen veprimet për secilin vit në zbatimin e aktiviteteve të objektives 1 , duke marrë parasysh edhe buxhetin (përveç rasteve kur nuk është e aplikueshme).		Pranohet	Është e paraparë në kuadër të dokumentit.
	5-Rekomandojmë që të caktohet numri i mjekëve që planifikohet të trajnohen përgjatë viteve të dhëna. Pra duke e caktuar bazën sa është aktualisht, dhe sa është numri që synohet të arrihet përgjatë viteve. Kështu të veprohet në të gjitha rastet e këtij plani të veprimit.		Pjesërisht	Siç dihet institucionet shëndetësore ballafaqohen me mugesë të mjekësve, andaj komuna do të shqyrtoj mundësinë që sipas prioriteteve të bëjë zgjidhje.
	6-Të specifikohen veprimet për secilin vit në zbatimin e aktiviteteve të objektives 2 , duke marrë parasysh buxhetin (përveç rasteve kur nuk është e aplikueshme).		Pranohet	Është e paraparë në kuadër të dokumentit.
	7-Sa leksione parashihen të ofrohen? Të përcaktohet numri sipas viteve.		Pranohet	Sipas nevojës.
	8-Angazhimi i këtyre mësuesve udhëtues të angazhuar duhet të definohet se a janë staf mbështetës që do të kujdesen vetëm për procesin mësimor të FNV-ve apo janë mësues të rregulltë, mirëpo që		Pranohet	Sa i përket të punës shtesë është e rregulluar me akte ligjore.

<p>punë shtesë e kanë edhe mbështetjen e FNV-ve.</p> <p>Kjo pasi ka indikacione buxhetore, ku varësisht nga përgjegjësia edhe të paguhen.</p>			
<p>9-Për të pasur një buxhet sa më real, nevojitet të planifikohet numri i mësuesëve potencial të angazhuar, si dhe kohëzgjatja e angazhimit të tyre.</p> <p>Në bazë të këtyre të dhënave mund të llogaritet edhe shpenzimi i buxhetit.</p>		Pjesërisht	Sipas mundësive dhe nevojave do të ketë angazhim të stafit arsimorë.
<p>10-Më lart është përcaktuar angazhimi i mësuesve dhe mësimeve por jo edhe i asistentëve. Ndërsa në këtë aktivitet po përcaktohet trajnimi i tyre.</p> <p>Duke e ditur rëndësinë e asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta në procesin mësimor, është e rëndësishme të shtohet edhe angazhimi i kësaj kategorie në këtë plan të veprimit dhe të përcaktohet buxheti për ta.</p>		Pjesërisht	Çdo angazhim i personelit për punë jo formale do të trajtohet përmes thithjes publike për mbështetjen e projekteve të tilla.
<p>11-Sa fushata parashihen të realizohen në secilin vit, respektivisht në të katër vitet? Të përcaktohet numri sipas viteve edhe duke marrë parasysh buxhetin.</p>		Pranohet	Sipas nevojës.
<p>12-Të specifikohet për secilin vit, se sa fushata vetëdijesuese parashihen të organizohen.</p>		Pranohet	Sipas nevojës.
<p>13-Sa aktivitete parashihen të organizohen?</p>		Pranohet	Sipas nevojës.
<p>14-Në kuadër të këtyre materialeve duhet të përfshihen libra që shërbejnë për të përmirësuar qasjen dhe pjesëmarrjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin mësimor. Këto libra duhet të përshtaten për të mbështetur lëndët e ndryshme dhe të</p>		Pjesërisht	Në koordinim me nivelin qendrorë do të kërkohet të realizohet kjo çështje.

përfshijnë elemente të tilla si alfabeti Brail, gjuha e shenjave, dhe metodat e tjera komunikuese, në përputhje me nevojat individuale të fëmijëve.			
15-Specifiko numrin e bursave që pritet të ndahen sipas viteve? Të korrespondoj me buxhetin		Pjesërisht	Sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.
16-Sa aktivitete pritet të organizohen në këto katër vite?		Pranohet	Sipas nevojës.
17-Edhe këtu të specifikohet numri i seancave që planifikohen të mbahen.		Pranohet	Sipas nevojës.
18-Të specifikohen veprimet për secilin vit në zbatimin e aktiviteteve të objektives 3 , duke marrë parasysh buxhetin (përveç rasteve kur nuk është e aplikueshme).		Pranohet	Është e paraparë në kuadër të dokumentit.
19-Sa fushata avokuese parashihen të implementohen në 4 vitet e ardhshme? Të specifikohen sipas viteve duke marrë në konsideratë buxhetin.		Pranohet	Sipas nevojës dhe mundësive buxhetor.
20-Kush është institucioni përgjegjës për këtë aktivitet?		Pranohet	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizatat përkresë.
21-Informimi/vetëdijësimi për punësim të PAK në sektorin privat mund të organizohet në kuadër të fushatës të lartpërmendur '1.6 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim të PAK në zyrat komunale për punësim' .		Pranohet	Komuna përmes programit të punësimit do të angazhoj persona me aftësi të kufizuara në institucione lokale.
22-Të specifikohen veprimet për secilin vit në zbatimin e aktiviteteve të objektives 4 , duke marrë parasysh buxhetin (përveç rasteve kur nuk është e aplikueshme).		Pranohet	Është brenda dokumentit.
23-Përveç fushatave vetëdijësuese dhe hulumtimeve, komuna duhet të ndërmarrë hapa konkret në përmirësimin e infrastrukturës		Pranohet	Komuna në kuadër të investimeve në infrastrukturë, po krijojnë qasje të lehtë për persona me aftësi të kufizuara.

	së PAK në rrugë-trotuar, objekt të komunës, gjykatës, parqeve, dedikimin e parkingjeve të veçanta për personat në karrocë, si dhe shqiptimin e dënimeve për qytetarët që uzurpojnë këto parkingje.			
	24-Të specifikohen veprimet për secilin vit në zbatimin e aktiviteteve të objektives 5 , duke marrë parasysh buxhetin (përveç rasteve kur nuk është e aplikueshme).		Pranohet	Është në kuadër të dokumentit.
	25-Organizimi i kësaj fushate mund të realizohet në kuadër të fushatës së lartpërmendur: ‘5.1 Organizohen fushata ndërgjegjësuese për të ftuar PAK në jetën publike’. Pasi natyra e informimit dhe vetëdijesimit në të dy rastet është ngjashme.		Pranohet	Është në kuadër të dokumentit.
8	1-Të shtohet aktiviteti " Krijimi i data bazës për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prizrenit, ku ky aktivitet të realizohet nga QPS dhe të planifikohet buxhet në vlerë prej 25 mijë euro.	Mimoza Çeku Rogova-Down Syndrome Kosova-Prizren (komenti pranuar në formë elektronike)	Pranohet	QPS-ja drejtorja, sociali kanë data bazën institucionale, kurse OJQ-të, duhet të punojnë në një data bazë formale për koordinim dhe zhvillim të aktiviteteve.
	2-Buxheti është jashtë zakonisht I ulët, jemi te vetëdijshëm që për vitin 2024 është aprovuar buxheti por duhet te insistohet që gjate periudhës kur rishikohet buxheti për vitin 2024 te shtohet buxhet për 6 mujorin e dYTE te vitit 2024, ndërsa për 3 vitet e tjera 2025,2026,2027, minimumi i buxhetit e duhet te ndahet.		Pranohet	Komuna për çdo vit buxhetorë sipas të hyrave ka rritur buxhetin për drejtoritë përkatëse, ky trend vazhdon.
	3-Te rritet buxhetit konform pragut minimal 600 mije euro per vit.		Refuzohet	Komuna për çdo vit buxhetorë sipas të hyrave ka rritur buxhetin për drejtoritë përkatëse, ky trend vazhdon.
	4-Per vitin 2024 kete aktivitet mendone ne 6 mujorin e dYTE 5000, ndersa ne tri vitet e		Pranohet	Do të përmirësohet

ardhshme për këtë aktivitet nuk ka nevojë për mjete, po e shtjelloj: gjate vitit 2024 behet një analize dhe përcaktohen prioritetet ku ne kuader te këtyre prioriteteve punohet tri vitet e ardheshme			
5-Nese mendohet te sjelljet ndonje ekspert nga jashte ky buxhet eshte shume i vogel.		Pranohet	Do të rishikohet buxheti.
6-Furnizimi me barna nuk mund te jete ne kompetencen e OJQ-ve, barnat duan trajtim dhe mirembajtje te vecante.		Pranohet	Institucionet e shëndetësisë lokale do ta trajtojnë këtë çështje në kuadër të furnizimit t me barna esenciale
7-Njejte vlen sikur tek hulumtimi te fushen e shendetesise, behet nje hulumtim hartohet raporti dhe konfrom raportit percaktohen prioritetet per tri vitet e ardheshem 2025,2026, 2026, buxheti 2500 euro eshte shume I vogel nuk mund te behet hulumtgim e as raport me kete vlere		Pranohet	Buxheti do të rishikohet.
8-Ne faqen 25, kolona e fundit-Ketu nuk ka nevoj per buxhet		Pranohet	Do të përmirësohet.
9-Te shtohet nje aktivitet per rritjen e numrit te profesionisteve brenda cerdheve kopshteve.		Pranohet	DKA, do të punojë në këtë drejtim.
10-Te pakten 10000 ne vitin 2025 per trajnimin e profesionisteve te kopshteve – shkollave.		Pjesërisht	Sipas nevojave.
11-NUK KA Buxhet, te pakten 100000 euro per vit duhet te jane per sherbimet qe kontraktohen OJQ-te, Komuna e Prishtines ndan 300000 ne vit, Komuna e Prizrenit me te Prishtines nuk dallojne shume as nga siperfaqja e as nga numri i banoreve		Pjesërisht	Komuna për secilin vit do të rris buxhetin për këtë fushë.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj


T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e strategjisë,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,

Raporti është përgatitur nga :

Haziz Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 291/22 Dt. 22.11.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Planit/Strategjisë Komunale për Persona me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Prizrenit.
2. Për anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
 - 2.1. Edmond Hoxha,.....kryesues i grupit,
 - 2.2. Egzona Hoxhaj,.....anëtare,
 - 2.3. Ymer Berisha,anëtar,
 - 2.4. Reshit Kushaj,anëtar,
 - 2.5. Vetan Xhemaj,.....anëtar,
 - 2.6. Idaim Kryeziu,anëtar,
 - 2.7. Bashkim Rakaj,anëtar,
 - 2.8. Përparim Shala,anëtar,
 - 2.9. Xhejlane Gjini,anëtare,
 - 2.10. Fatlum Berisha,anëtar,
 - 2.11. Një përfaqësues nga OJQ "Ec Ma Ndryshe",
 - 2.12. Nga një përfaqësues të OJQ-ve që merren me persona me nevoja të veçanta,
 - 2.13. Një përfaqësues nga OSBE-ja, anëtar.
3. Grupi Punues sipas nevojës mund të angazhoj edhe persona tjerë në këtë Grup Punues.
4. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 2 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Draft Planin/Strategjisë Komunale për Persona me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Prizrenit, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe pas hartimit të draftit përkatës, ti procedohet organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.
5. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi nr. 01/060-0068383/22 i datës 13.05.2022.
6. Obligohet kryesuesi i Grupit Punues dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Kryesuesit të Grupit Punues,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

M Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen të gjithë banorët e komunës së Prizrenit për organizimin e konsultimit publik për: Projekt- Strategjinë komunale dhe planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027.

Data :20.12.2023

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë).

Ora : 10:00

Të dashur qytetarë/e,

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Projekt- Strategjisë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643 dhe Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt- Strategjinë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **11.12.2023** deri me datën: **11.01.2024**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **20.12.2023**, në sallën mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë) me fillim në ora 10:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **11.01.2024** në ora **16:00**, në emailat e zyrtarëve: Edmond.Hoxha@rks-gov.net , Kumrije.Bytyqi@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Për më shumë detaje për Projekt-Strategjinë, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën strategji në konsultim publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/konsultime-publike/strategjite-ne-konsultim-publik/>

Platformën për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Ymer Berisha

PER: 
Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 770/23 Dt. 11.12.2023



JAVNO OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi građani opštine Prizren, za organizovanje javnih konsultacija za opštinski Projekt-Strategiju i plan delovanja za osobe sa ograničenim sposobnostima 2024-2027.

Dana: 20.12.2023

Mesto: Sala Skupštine opštine - Bela Kuća.

Vreme: 10:00

Poštovani građani,

Opština Prizren je preko radne grupe za izradu opštinske Projekt - Strategije i plan delovanja za osobe sa ograničenim sposobnostima 2024-2027, na osnovu Zakona br. 03/L-040, za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren. br. 01/011-5643 i člana 6 Administrativnog Uputstva (MALS) br. 06/2018 za minimalne standarde javnih konsultacija u opštinama, izdaje ovo:

JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organiziranjem javne konsultacije sa građanima za Opštinsku Projekt - Strategije i plan delovanja za osobe sa ograničenim sposobnostima 2024-2027

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **11.12.2023** do **11.01.2024**, dok će se javna konsultacija sa građanima održati **20.12.2023**, u sali za sastanke Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **10:00** časova.

Komentare i sugestije možete slati do **11.01.2024** do **16:00**, na mejlove službenika: Edmond.Hoxha@rks-gov.net, Kumrije.Bytyqi@rks-gov.net i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Za više detalja, za Projekt – Strategiju, možete posjetiti sledeće linkove:

Službena web stranica u rubrici Planovi na javnoj konsultaciji:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/konsultime-publike/strategije-ne-konsultim-publik/>

Platforma za Javne Konsultacije:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Ymer Berisha

per: 
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 770/23 Dt. 11.12.2023



KAMU BİLDİRİSİ

2024-2027 yılı Engellilere yönelik belediye taslak eylem planının ve stratejisi ile ilgili kamu istişarenin düzenleneceği tüm Prizren Belediye sakinlerine duyurulur.

Tarih :20.12.2023

Yer: Belediye Meclis toplantı salonunda (Beyaz Ev) .

Saat : 10:00

Sevgili vatandaşlar,

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün ve 06/2018 sayılı Belediyelerde Asgari Kamu İstişare Standartları için İdari Yönergenin (YYB) 6. Maddesi gereğince Prizren Belediyesi, 2024-2027 yılı Engellilere yönelik belediye taslak eylem planının ve stratejisinin tasarlanmasına yönelik çalışma grubu aracılığıyla işbu duyuruyu sunmaktadır:

2024-2027 yılı Engellilere yönelik belediye taslak eylem planının ve stratejisi ile ilgili vatandaşlarla kamu istişarenin düzenlenmesi için
KAMU BİLDİRİSİ

Söz konusu belge **11.12.2023 - 11.01.2024** tarihine kadar kamu istişarede olacaktır. Halkla kamu istişare ise **20.12.2023** tarihinde Belediye Meclisin toplantı salonunda (Beyaz Ev) saat **10:00** başlamak üzere düzenlenecektir.

Yorum ve önerilerinizi **11.01.2024** tarihinde saat **16:00** kadar: Edmond.Hoxha@rks-gov.net , Kumrije.Bytyqi@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .Haziz.Krasniqi@rks-gov.net yetkililerin e – posta adreslerine iletebilirsiniz.

Taslak strateji ile ilgili daha fazla bilgi için aşağıdaki siteleri ziyaret edebilirsiniz:

Resmi web sitenin kamu istişare yönetmelikler kısmında:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/konsultime-publike/strategijite-ne-konsultim-publik/>

Kamu İstişare Platformu:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Ymer Berisha

Halkla İletişim Birim Yöneticisi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 770/23 Dt. 11.12.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve të **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për Projekt-Strategjinë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftimet-ftesat për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

10:30-11:37

Nr	Emri/mbiemri	Vendi/ institucioni/ OJQ	Emaili	Nënshkrimi
1	Resnije PRANIMANI	OPDMK	[REDACTED]	R.
2	Antigona Sestari	OPDMK	[REDACTED]	Antigona Sestari
3	Yllka Berisha		[REDACTED]	Y. Berisha
4	Zef Davi		[REDACTED]	Z. Davi
5	TRINGA KASEMI		[REDACTED]	Kasemi
6	MINOLE ROGOVA	DSE	[REDACTED]	[REDACTED]
7	Pëtrpëri Krasniqi	SHK.V. PZ	[REDACTED]	[REDACTED]
8	Kamije Bytyj	QPS	[REDACTED]	[REDACTED]
9	Yelime Gecaj	SHK	[REDACTED]	Gecaj
10	Muhamed Shale	QPS-	[REDACTED]	[REDACTED]

Përgatiti:



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve të **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për Projekt-Strategjinë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftimet-ftesat për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

10:30 – 11:37

Nr	Emri/mbiemri	Vendi/ institucioni/ OJQ	Emaili	Nënshkrimi
1	Erull Shabani	EC Ma Kodër	[Redacted]	[Signature]
2	Arin Shabani	Q.P.S. PZ	[Redacted]	[Signature]
3	[Redacted] (Krye)	Q.P.S. PZ	[Redacted]	[Signature]
4	Enver Kryeziu	Q.P.S. PZ	[Redacted]	[Signature]
5	Egzencia Hashan	KK PZ	[Redacted]	[Signature]
6	EROLINA MORINA	ISOY	[Redacted]	[Signature]
7				
8				
9				
10				

Përgatiti: